

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"AP LEGAL AND TAX CONSULTING" SHPK**

Sot me date 6. 01.2023,

Z. **Erkin Qiraxhi**, lindur me 10.07.1985, ne Korce, banues ne Tirane, mbajtes i kartes se identitetit nr. personal I50710104H, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, me vullnetin e tij te lire e te plote,

nepermjet ketij akti themelojne sot, nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe kushteve te parashikuara me poshte:

**I.**

**Krijimi**

1.1 Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar AP Legal and Tax Consulting SHPK (me poshte e quajtur "Shoqeria"), themelohet ne baze te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.

**II.**

**Objekti**

2.1 Shoqeria, do te kete per objekt te veprimtarise se saj aktivitetet e meposhtme: kryerjen e sherbimeve ne fushen e avokatise dhe ne ato fusha qe i sherbejne ketij qellimi. Dhënie e këshillave për çështje ligjore, civile, penale, administrative, tatimore dhe financiare, personave fizik dhe juridik, shqiptar dhe të huaj. Përgatitjen e kërkesave të ndryshme drejtuar institucioneve publike apo personave të tretë privatë. Përgatitje të kërkesave ankimore kundër vendimeve gjyqësore, akteve të prokurorit, organeve të arbitrazhit apo të administratës shtetërore në përgjithësi. Përgatitjen e dokumentacionit për personat Juridik. Përgatitjen e akteve që duhet të përpilohen para noterit. Hartimin e kontratave apo marrëveshjeve të tjera me palë private ose publike. Pjesëmarrjen si mbrojtës gjatë gjithë fazave të procedimit penal. Përfaqësimin e palëve gjatë proceseve civile, administrative etj. Përfaqësimi në raste aksidentesh, dëmshpërblimi pasuror dhe jopasuror.

**III.**


**Zyra qendrore**

3.1 Zyra qendrore e Shoqerise eshte ne adresen: Rruga "Bedri Karapici", Kompleksi Tirana Golden Park, seksioni 5/1, Kati 5, Ap. 19;

3.2 Shoqeria mund te hape edhe zyra dhe/ose te kryeje aktivitete ne vende te tjera si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, sipas vendimit te Shoqerise.

**IV.**

**Kohezgjatja**



4.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

V.

### Kapitali Themeltar

#### Kapitali Themeltar dhe Ortaket e Shoqerise

5.1 Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 leke. Kapitali i Shoqerise ndahet ne 1 kuote me vlere nominale 100 leke.

5.2 I gjithe kapitali themeltar eshte nenshkruar ne para nga Ortaku i Vetem i Shoqerise.

5.3 Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ne çdo moment sipas kushteve te parashikuara nga ligji shqiptar.

5.4 Pergjegjesia e ortakeve per mbulimin personalisht te humbjeve te Shoqerise shtrihet deri ne vleren e pashlyer te kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise. Ortaku i Vetem i Shoqerise, Z. Erkin Qiraxhi, zoteron 100% te kuotave te Shoqerise.

VI.

### Administrimi

6.1 Shoqeria administrohet nga nje administrator, person fizik, i cili emerohet nga Ortaku i Vetem sipas Statutit te Shoqerise.

6.2 Administratoret emerohen per nje periudhe 5 (vjeçare) dhe mund te riemerohen.

6.3 Administratori i Shoqerise emerohet: **Znj. Eresta Troka**, e datelindjes 11.08.1996, lindur ne Fier dhe banuese ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit me nr. personal J65811010T.

6.4 Administratori/et shkarkohet/n nga detyra ne çdo kohe, me vendim te Ortakut te Vetem sipas Statutit te Shoqerise.

6.5 Kompetencat e administratorit/eve te Shoqerise percaktohen dhe rregullohen ne Statutin e Shoqerise.

VII.

### Viti ushtrimor

7.1 Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti kalendarik. Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon ne daten e regjistrimit ne Regjistrin Tregetar dhe perfundon me 31 Dhjetor te vitit ne vazhdim.


7.2 Ky akt themelimi eshte hartuar ne pese kopje ne gjuhen shqipe, secila njelloj e vlefshme.

Nenshkruar nga Ortaku i vetem i Shoqerise:

1. Erkin Qiraxhi

Sot, me date 16.01.2023.

ORTAKU I VETEM

  
Z. Erkin Qiraxhi

